



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.79/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Emsale Selmani, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i pasafatshëm apeli i identifikuar me numër: A.nr.79/2019, i datës 22.09.2019, i parashtruar nga Emsale Selmani, me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 22.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Emsale Selmani, në të cilin parashtruesja e apelit pretendon se i është mohuar e drejta për të votuar pasi që të njëjtës i është refuzuar kërkesa për tu futur në listën e votuesve jashtë Kosovës, me arsyetimin se nuk i ka përmbushur kushtet e parapara ligjore, andaj ka kërkuar nga PZAP-i që t'i mundësohet e drejta e votës në Kosovë.

Paneli pas vlersimit paraprak të afatshmëris së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Emsale Selmani kundër vendimit të KQZ-së, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par.1 të LZP-së, ku përcaktohet: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve”*. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lendes rezulton se periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar nga data 30.08.2019 dhe ka përfunduar me datë 10.09.2019. Vendimi i KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër) orë nga marrja e vendimit. Apeli në PZAP nga parashtruesi i apelit, është paraqitur me datë 22.09.2019, çka

do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar në dispozitën ligjore të nenit 122 par.1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 par.1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 79/2019 me datë 23.09.2019

**Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

